



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR

Nr.835/3. Prot.

Tiranë, më 19.10.2023

SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në mbështetje të neneve 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, vendimin nr. 148, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”, Vendimeve nr. 1, datë 23.05.2023 dhe nr. 3, datë 28.09.2023 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin si më poshtë:

- **1 (një) pozicion – Specialist i Burimeve Njerëzore, në Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, IV-1.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë! Në se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

LËVIZJE PARALELE:

02.11.2023

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

09.11.2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Ndihmon në krijimin dhe administrimin e Regjistrit të Personelit të Gjykatës si dhe të dosjes personale për të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të punonjësve të tjerë të gjykatës, sipas ligjit;
2. Harton dokumente dhe programe që lidhen me personelin, si pajisja dhe plotësimi me librezat pune, përpilimi i kontratave individuale të punës dhe nënshkrimi i tyre nga punëdhënësi e punëmarrësi, përpilimi i grafikut të lejeve vjetore për personelin administrativ;
3. Ndihmon në kryerjen e detyrave që lidhen me hartimin e përshkrimeve të punës, si dhe çështje të tjera që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë sipas ligjit;
4. Ndihmon në procesin e rekrutimit të punonjësve të tjerë të gjykatës sipas ligjit, duke përgatitur të gjitha dokumentet dhe aktet e nevojshme për këtë qëllim;
5. Merr masa për t'i plotësuar personelit të gjykatës materialet e nevojshme kancelarike dhe çdo pajisje tjetër, kujdeset për plotësimin e kërkesave për karburant e pjesë këmbimi të automjeteve të institucionit dhe siguron gatishmërinë e mjeteve, kujdeset për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe të zyrave, për sigurimin me energji elektrike dhe lidhje telefonike, si dhe për krijimin e lehtësirave të nevojshme për veprimtarinë e gjykatës;
6. Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve dhe aparaturave, dhe kur konstatohet se dëmtimet e tyre kryhen me faj, nxjerr përgjegjësinë personale dhe parashtron propozimet për zhdëmtim;
7. Kontrollon përdorimin me korrektësi të mjeteve, pajisjeve dhe automjeteve, si dhe ndalon çdo keqpërdorim e shfrytëzim abuziv të tyre;
8. Kryhen në mënyrë periodike respektimin e orarit të punës të stafit të gjykatës dhe raporton pa vonesë tek kancelari;
9. Kryen detyra të tjera, sipas urdhrave apo porosive të kryetarit, kancelarit apo Këshillit të Gjykatës.
10. Mban kontakte të vazhdueshme me drejtorinë përkatëse në Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me çështje të Regjistrit Qendror të Personelit;
11. Siguron raportim në kohë dhe në formën e duhur nga kancelari për çështje të burimeve njerëzore të gjykatës.
12. Përgatit materiale apo shkresa të ardhura në institucion apo ato të cilat ju drejtohen të tretëve sipas porosive të eprorëve;
13. Trajton me imtësi çështje që kanë të bëjnë me statusin e nëpunësit civil gjyqësor;
14. Krijon dosjen personale për çdo punonjës të gjykatës ku përfshihen vlerësimet e punës, masat disiplinore, dëshmitë dhe certifikatat për kurse e veprimtari kualifikimi, si dhe çdo e dhënë tjetër që ka të bëjë me ecurinë profesionale të personit;
15. Kujdeset për hartimin e draft akteve/vendimeve të Këshillit Gjyqësor në lidhje me

- statusin e nëpunësit civil gjyqësor;
16. Punon brenda procedurave dhe orientimeve të përcaktuara nga kancelari dhe/ose Këshilli i Gjykatës;
 17. Përdor pajisjet teknike të disponueshme, si dhe sistemet/regjistrat elektronik të tjerë të personelit të gjykatës.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon IV-1;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Arsimi: Të jetë diplomuar në drejtësi ose fusha të tjera përkatëse që janë në përputhje me këtë përshkrim të pozicionit të punës, të paktën në nivelin Bachelor sipas ligjit;
- Përvoja: Të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoja tjetër profesionale.
- Ka përparësi: Të zotërojë shumë mirë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së; Aftësi komunikuese dhe organizative; Të ketë njohuri mesatare në përdorimin e Programeve të *Microsoft- Word dhe Excel*.

Të japin pëlqimin për plotësimin e kushteve të sigurisë të përcaktuar në ligjin nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe në nenin 41 të Vendimit të KLGJ-së, nr. 622 datë 10.12.2020, si më poshtë:

- a) deklaratën e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit sipas formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”. Nëse, gjatë 180 ditëve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll të kryer prej Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur;
- b) deklaratën për kontrollin e figurës, së bashku me deklaratën e vërtetësisë të të dhënave dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen, kryerjen e kontrollit,

aksesin dhe administrimin e të dhënave personale, sipas shtojcës A, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

c) vetëdeklarimin e kandidatit, sipas shtojcës B2 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

ç) vetëdeklarimin e anëtarëve të familjes së kandidatit, sipas shtojcës B3, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim për vendin që konkuron
- b) Jetëshkrim i plotësuar (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c) Fotokopje të **noterizuar** të diplomës; për diplomat jashtë vendit, duhet të jenë të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Fotokopje të **noterizuar** të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal;
- i) Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
- j) Vërtetim banimi;
- k) Çertifikatë familjare;
- l) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- m) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- n) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- o) Formularët e Deklarimit të Pasurisë, si dhe formularët A, B2, B3 të përcaktuar në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, (me anë të të cilave jep pëlqimin për kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, si dhe dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake).

(Formularët gjenden të publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi).

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Për procedurën levizje paralele Kandidati duhet të paraqese zyrtarisht dokumentet brënda datës 02.11.2023 pranë Kryesekretarisë së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ose nëpërmjet shërbimit postar.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **06.11.2023** Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), si më poshtë:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari njofton individualisht me email kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre.

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht, në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin e kandidatit me më shumë pikë, nga lista e hartuar.

Këshilli, ku emërohet nëpunësi civil gjyqësor i ri, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele, njofton KLGJ-në për rezultatet e procedurës.

Njoftimi me emrat e nëpunësve fitues shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, Këshilli përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe njofton KLGJ-në, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data **10.11.2023**.*

II.1. KUSHTET PËR PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e “Pranimit në shërbimin civil gjyqësor”:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e institucioneve, të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil gjyqësor dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Arsimi: Të jetë diplomuar në drejtësi ose fusha të tjera përkatëse që janë në përputhje me këtë përshkrim të pozicionit të punës, të paktën në nivelin Bachelor sipas ligjit;
- Përvoja: Të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoja tjetër profesionale.
- Ka përparësi: Të zotërojë shumë mirë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së; Aftësi komunikuese dhe organizative; Të ketë njohuri mesatare në përdorimin e Programeve të *Microsoft- Word dhe Excel*.

Të japin pëlqimin për plotësimin e kushteve të sigurisë të përcaktuar në ligjin nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe në nenin 41 të Vendimit të KLGJ-së, nr. 622 datë 10.12.2020, si më poshtë:

- a) deklaratën e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit sipas formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”. Nëse, gjatë 180 ditëve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll të kryer prej Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur;
- b) deklaratën për kontrollin e figurës, së bashku me deklaratën e vërtetësisë të të dhënave dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen, kryerjen e kontrollit, aksesin dhe administrimin e të dhënave personale, sipas shtojcës A, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- c) vetëdeklarimin e kandidatit, sipas shtojcës B2 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- ç) vetëdeklarimin e anëtarëve të familjes së kandidatit, sipas shtojcës B3, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dokumentat, deri më datë 09.11.2023 si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim për vendin që konkurron
- b) Jetëshkrim i plotësuar (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c) Fotokopje të **noterizuar** të diplomës; për diplomat jashtë vendit, duhet të jenë të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Fotokopje të **noterizuar** të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal;
- i) Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
- j) Vërtetim banimi;
- k) Çertifikatë familjare;
- l) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- m) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- n) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- o) Formularët e Deklarimit të Pasurisë, si dhe formularët A, B2, B3 të përcaktuar në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, (me anë të të cilave jep pëlqimin për kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, si dhe dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake).

(Formularët gjenden të publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi).

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentet brënda datës 09.11.2023 pranë Kryesekretarisë së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ose nëpërmjet shërbimit postar.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.11.2023** Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil gjyqësor dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil gjyqësor dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”.
- Ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.

40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.

- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PER KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij www.klgj.al.